



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261151

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06297430

C-IV.-14-6767

Paditësi:

Q Enga f.sh R K.Viti.

Kundër

E paditura:

1.Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë,

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.10 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit Q E

2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.29 tetor 2014, për paditësin Q E ka paraqitur ankesë në gjykatë F E kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI035-0160 dt.03.10.2014 me të cilin ishte vërtetuar kompensimi i dëmshpërblimit për paga të pa paguara në shumë prej 600.00€ nga NSH “Agromorava”.

Duke vepruar sipas kësaj lënde gjykata me dt.06 gusht 2024, ka dërguar një urdhër për ankuesin që të bëjnë dorëzimin e provave shtesë duke ia specifikuar secilën veç e veç si dhe

kopjen e vendimit të kundërshtuar. Urdhëri nuk ka mundur që ti dorëzohet, me dt.17.08.2024 zyrtari postar kishte konstatuar “i vdekur, shtëpia e mbyllur”.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit Q E

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.”*

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala